



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina



E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

**të mbledhjes urgjente të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 10.04.2020,
duke filluar në orën 13:00.**

Në mbledhje morën pjesë: Shpend Ahmeti, Kryetari i Komunës, Agim Kuleta, kryesues i Komitetit, anëtarët e Komitetit: Halim Halimi, Agim Gashi, Jeta Rafuna, Fadil Gashi, Vala Peshku, Sami Boroci, Egzon Azemi dhe Genc Sherifi.

Mungoi: Blerand Stavileci.

Morën pjesë edhe: Osman Bllaca, përfaqësues i ekzekutivit, Valbona Ahmeti - Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, Bujar Gashi, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë, Shpresa Shala, drejtoreshë e Drejtorisë së Arsimit dhe Genc Bashota, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoit **Agim Kuleta, kryesues**, i cili tha se jemi në mbledhjen urgjente dhe për këtë mbledhje propozohet ky

REND DITE:

- 1. Propozimvendimi për aprovin e pakos ekonomike me rastin e Covid 19;**
- 2. Propozimvendimi për bartjen e buxhetit nga viti 2019.**

Kryesuesi ia dha fjalën Kryetarit, Shpend Ahmeti.

Kryetari, Shpend Ahmeti, dha sqarime lidhur me dy pikat e rendit të ditës, duke bërë të ditur se sa i përket bartjes, i kemi rrëth 40 milionë euro të kontraktuara, projekte që janë me kontratë, investime kapitale dhe bartjet, pra janë për çdo investim kapital, ose shuma e plotë e kontratës që ka mbetur e nënshkruar e që ka mbetur gjysmë dhe puna duhet zbatuar, ose disa raste i kemi parashikuar se sa mundemi të shpenzojmë nga ajo kontratë, atë çka kemi bërë me bartje, në mënyrë që me ruajtur buxhetin sivjet.

Në qoftë se na duhet pasur një muaji, prapë është që 1 milion të kësaj pakoje të masave ekonomike, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, kemi arritur që me i lëvizur prej investimeve kapitale në subvencione, pra që me i shpenzuar një pjesë të bartjes në subvencioneve. Ne i kemi paraparë 14 pika, të cilat nevojiten apo kërkojnë aprovim.

Pika e parë dhe e dytë, është shpërndarja e 5000 pakove higjenike dhe ushqimore. Deri tani i kemi shpërndarë rreth 1700 pako higjenike, të cilat janë dedikuar për familjet në asistencë sociale në komunitetin RAI, dhe disa kërkesa që kanë ardhur në Qendrën e thirrjeve, për familjet me gjendje të rëndë ekonomiko - sociale, dhe prej javës së ardhme fillojmë me shpërndarjen e pakove familjare.

Pika e tretë, i kemi pajisjet shëndetësore, në vlerë prej 200.000 euro, kemi blerë mjaftueshëm dorëza, maska, mirëpo nuk po dihet se sa do të jenë nevojat.

Pika e katërt, është buxheti për dezinfektim, deri në 200.000 euro, ku gati e kemi përfunduar dezinfektimin e të gjitha objekteve kolektive në Prishtinë, dezinfektimin e të gjitha hapësirave komunale, dezinfektimin e të gjitha shkollave dhe të gjitha çerdheve në komunën e Prishtinës.

Pika e pestë, të gjitha bizneset që janë me qira në lokale të cilat janë pronë e ndërmarrjeve publike lokale të Prishtinës, të lirohen nga qiraja prej ditës kur kanë filluar masat restriktive. Fjala është për Ndërmarrjen Publike Banesore dhe Pallatin e Rinisë. Meqenëse është program i Qeverisë, që i paguan deri 50% të qirasë për biznese që janë me qira, dhe ne i kemi verifikuar me Qeverinë, të përfshihen edhe këto biznese që janë me qira në Ndërmarrjen Publike Banesore dhe Pallatin e Rinisë, ne do t'i lirojmë nga qiraja për pjesën që nuk mbulohet nga Qeveria.

Pika e gjashtë, të gjitha bizneset e sektorit të gastronomisë që paguajnë takse për shfrytëzimin e hapësirave publike, lirohen nga pagesa për një vit (një sezoni veror dhe një dimër).

Pika e shtatë, NPL "Stacioni i Autobusëve" e ka ndërprerë komplet funksionimin, nuk ka asnjë të hyrë, shpenzimet e pagave arrijnë vlerën prej 80.000 euro, andaj mendoj që në Kuvend ta aprovojmë shumën e saktë sa i duhen për paga mujore të cilat kanë dhe aq t'i transferojmë.

Pika e tetë, çerdhet me bazë në komunitet do të subvencionohen për pagat e punëtorëve, kostojat e të cilave është 50.000 euro në muaj.

Pika e nëntë, lirohen nga pagesa të gjithë prindërit e fëmijëve në çerdhe publike për periudhën që çerdhet do të qëndrojnë të mbyllura.

Pika e dhjetë, NPL "Prishtina Parking" ka filluar së funksionuari dhe tashmë ka angazhuar personel dhe ka transferuar punëtorët prapa Pallatit të Rinisë. Kjo ndërmarrje do të subvencionohet me 50.000 euro.

Sa i përket pikës së njëmbëdhjetë dhe pikës së dytëmbëdhjetë, kemi menduar për një subvencionim për sport dhe kulturë, në vlerë prej 100.000 euro.

Pika e trembëdhjetë, kemi katër ndërmarrje tjera që do të preken financiarisht nga masat restriktive, si "Trafiku Urban", që është ndërprerë komplet, po presim ta shohim saktë se sa do të na nevojiten për pagat e punëtorëve, dhe për këtë duhet ta ftojmë edhe një mbledhje të Kuvendit të Komunës kur të jemi gati me këto vlera.

Sa i përket ndërmarrjes "Hortikultura", janë dy të hyra që ju kanë shkuar zero, është laura e Gërmisë, e cila i siguron rreth 200.000 euro në vit për ndërmarrjen "Hortikultura", dhe e kemi Tregun e makinave, i cili po ashtu iu siguron të hyra të dielave. Pasi ta vlerësojmë, do të shikojmë se me çfarë buxheti do ta ndihmojmë ndërmarrjen "Sport Marketing", e cila ka numër të vogël të punëtorëve, por duhet të shohim se si t'iu ndihmojmë.

Sa i përket ndërmarrjes "Pastrimi", na duhet më shumë kohë për me definuar për disa arsyen, një është se nuk iu kanë falur faturat e pastrimit, ato vetëm iu kanë mundësua qytetarëve me u shtyrë, me u paguar më vonë, e cila shkakton problem në kesh-fllotë të kompanisë, megjithatë në pakon e Qeverisë është një pikë, që thotë se ndërmarrjeve publike do t'u lejohet marrja e huazimit për ta menaxhuar kesh-fllotën, për të cilin nuk i kam detajet e sakta, prandaj na duhet një takim tri palësh, në mes të Komunës, Pastrimit dhe Ministrisë, ta kuuptojmë se sa saktësish ju nevojiten. Pra na duhen më shumë detaje, sepse nuk mund të vendosim subvencionimin pa pasur informatën.

Pika e katërbëdhjetë, ne po mendojmë ta themelojmë një program të granteve për bizneset, të vetëpunësuarit, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Aplikacionin e kemi përgatitur, është i lidhur me Administratën Tatimore, ideja është që një biznes mund ta fitojë varësisht prej kategorisë për grant pas përfundimit të Covid 19. Vlera e këtij fondi varet nga diskutimet me Ministrinë e Financave. Mendoj se ky program duhet të jetë minimum 5 milion euro, besoj se kemi mundësi si Komunë e Prishtinës. Patjetër duhet të kemi një fond të tillë si Komunë e Prishtinës, për shkak se e kemi edhe mundësinë ta bëjmë një gjë të tillë.

Këto janë 14 pikat e propozuara nga ne për sot në këtë mbledhje të Kuvendit. Mendoj që brenda një javë, apo 10 ditëve, do të kemi prapë ndonjë takim për ndonjë çështje urgjente, të cilën mund ta kemi posaçërisht për këto katër ndërmarrjet që i përmenda. Mendoj se këto ndërmarrje duhet të ndihmohen, por duhet të vlerësojmë saktë se në çfarë shume duhet të ndihmojmë.

Në vazhdim kryetari dha sqarime edhe për situatën aktuale në komunën e Prishtinës lidhur me pandeminë Coronavirus, Covid 19.

Halim Halimi tha se ne i morëm sqarimet në detaje nga kryetari për këto pika, mirëpo a nuk keni pasur mundësi që këto material me na i dërguar një ditë më parë, sepse për bartjen e buxhetit keni mundur me bërë një muaj më herët, sepse ne tani jemi të papërgatitur, e dimë që është i nevojshëm aprovimi i kësaj pakoje, por ne jemi të papërgatitur, besoj se keni mundur me na i dërguar një ditë më parë.

Kryetari, Shpend Ahmeti, tha se nuk kemi mundur me i dërguar materialin më herët, për shkak se Ministrinë e Financave e kemi pritur me na dhënë përgjigje se a mundet me na lejuar me i qitë këto subvencione dhe a kemi me u mbuluar. Sot na thanë se mundemi me i lejuar, e kemi caktuar edhe kodin buxhetor.

Sa i përket bartjes, e kemi pasur gati tash e një kohë, për mos me shpenzuar buxhetin e sivjetshëm, që mundet me na u nevojitur për tjetër çka, kemi dashtë këtë bartje me shti edhe këtë pako 1 milionëshe dhe e kemi shtuar këtu.

Egzon Azemi theksoi se propozimet në përgjithësi ishin të mira, mirëpo a kishte pasur mundësi me u përfshirë te pjesa e taksës për shfrytëzimin e hapësirave publike, ku i keni specifikuar veçanërisht bizneset e gastronomisë, me u përfshi edhe bizneset e vogla te lirim i prej tatimit që e paguajnë për pronë për dyqane që kanë etj.

Kryetari, Shpend Ahmeti, dha sqarime, duke cekur se Komuna nuk ka të drejt askënd me liruar prej tatimit në pronë, mirëpo për taksat e lejeve ua kemi shtyrë mundësinë e pagesës së lejes, ndërsa atë taksën që e kemi për disa lloje të bizneseve, për banka, barnatore edhe për markete, të cilat sipas meje duhet me ua hequr, se kanë bërë punë më shumë se zakonisht.

Egzon Azemi, lidhur me fonde që i keni propozuar për NP, me këtë mundësinë që e përmendët që e ka dhënë Qeveria për ndërmarrjet publike, që mund të aplikojnë në këtë grant qeveritar për kredi pa kamatë, ky është një lloj huazimi që ia bën Ministria secilës ndërmarrje. Unë mendoj se ndoshta kishte qenë mirë me ruajtur sa më shumë buxhetin komunal dhe me pasur mundësi me i shfrytëzuar këto hapësira që i jap Ministria, në mënyrë që nëse zgjat kjo situatë, me pasur fonde të mjaftueshme dhe me i destinuar diku tjetër.

Kryetari, Shpend Ahmeti, dha sqarimet e nevojshme.

Egzon Azemi tha se është mirë që 5% që është lejuar prej Ministrisë së Financave, me u shfrytëzuar prej investime kapitale, është një mundësi tjetër që besoj se mundemi me shfrytëzuar.

Kryetari, Shpend Ahmeti, theksoi se atë e kemi shfrytëzuar dhe prapë do ta shfrytëzojmë edhe në të ardhmen.

Egzon Azemi tha se te bartja, besoj e keni diskutuar me Ministrinë, se kështu, me sa e di unë, nuk është e ligjshme, mirëpo për shkak të rrethanave në këtë situate ndoshta lejohet.

Kryetari, Shpend Ahmeti, dha sqarime, duke cekur se çdo gjë që e kemi shfrytëzuar për Covid 19, Qeveria ka kërkuar me futur në një kod të veçantë, i ka ndarë 10 milionë euro për komunat që janë të prekura nga masat e Covid 19, ndoshta edhe kemi me i kthyer këto para prej Qeverisë, ndoshta prej këtij 1 milion që e kemi, 500 000 ka me na i dhënë Qeveria pasi ta bëjmë aplikimin.

Egzon Azemi theksoi se prej pikave që me u hequr prej fondevë, ndoshta është dashur me i rishikuar tri, siç është pika 89, shtimi i puseve, Lloto 1,2, pika 99, rregullimi i pompave, dhe pika 101, pajisja për zjarrfikës, se këto që të tria janë projekte të rëndësishme që ndërlidhen edhe me menaxhimin e situatës, ku dy janë që ndërlidhën direkt me ujin dhe që është një ndër masat elementare.

Kryetari, Shpend Ahmeti, tha se asnjë cent nuk ua kemi hequr, e ke vlerën e kontratës, sa kanë imbetur dhe sa po barten.

Egzon Azemi bëri të ditur se dje kishin marrë një kërkesë prej banorëve të lagjes "Kurti në Barilevë, ku ishin rreth 30 shtëpi të cilat nuk kishin ujë të pijes, por që kishte zgjidhje për këtë çështje, që nga lagjja "Llumnicët", që ishte shumë afër tyre, dhe kishte mundësi të realizohet me rënje të lirë, pa pasur nevojë për pompa për bartjen e ujit. Nëse kishim pasur mundësi me rishikuar këtë situatë, për shkak se ishte një gjendje më e rrezikshme se në vendet tjera.

Kryetari, Shpend Ahmeti, tha se për këtë duhet biseduar me kompaninë e ujësjellësit.

Fadil Gashi shprehu mendimin se këto dy ndërmarrje, sidomos "Pastrimi" dhe "Hortikultura", duhet të hyjnë në këto pika, se dikur është vonë, sepse aty nuk janë vetëm të ardhurat e punëtorëve, aty ka edhe prishje të kamionëve e mjete të tjera, kështu që edhe Qeveria nuk e ka paraparë në këtë pako. Unë mendoj se punëtorët e pastrimit janë më të rrezikuarit, pas infektives, kështu që duhet pasur parasysh këtë.

Kryetari, Shpend Ahmeti, theksoi se për ta caktuar vlerën e saktë, ndoshta na duhet edhe një javë për t'i definua të gjitha punët.

Sami Boroci e përgëzoi Komunën në këtë situate aktuale për një qasje, menaxhim, që ndoshta është më i miri prej të gjitha komunave.

Sa i përket pikës së trembëdhjetë, "Pastrimi", unë besoj se na duhet patjetër në këtë fazë me gjetur një modalitet, me subvencionuar me një shumë të caktuar, se është ekspozuar rreziku dhe në bazë të informatave që i kam, ndërmarrjes "Pastrimi" i ka rënë arkëtimi bukur shumë.

Kryetari, Shpend Ahmeti, tha se arkëtimin për ndërmarrjen "Pastrimi" e bëjmë ne, ne jemi duke ia paguar shërbimin ndërmarrjes "Pastrimi".

Agim Gashi bëri të ditur se edhe në emër të prishjeve që iu bëhen në mekanika, edhe ato paguhen nga Komuna, sepse ata nuk marrin mjete prej tjetërkujt, të vetmin burim e kanë Komunën.

Sami Boroci theksoi se e kam një rekomandim për Ministrin e Shëndetësisë. Unë mendoj se në këtë fazë, duke e pasur parasysh se i kemi goxha kritike këto dy javë, pasi ka ardhur që komunat me Ministrinë me i paraparë masat, ndoshta kishte qenë e rrugës me kërkuar që gjatë këtyre dy javëve me i shtrënguar masat, sidomos kohën e lëvizjes.

Kryetari, Shpend Ahmeti, tha se sot kam takim me znj. Vjosa Osmanin dhe me z. Arben Vitia, ku do t'i diskutojmë edhe këto çështje.

Sa i përket ndërmarrjes "Pastrimi", kishte qenë mirë ne këtu me u pajtuar e mos të shkojmë në Kuvend me zgjeruar diskutimin me 52 veta.

Agim Gashi tha se te ndërmarrja "Pastrimi" mungojnë informatat për obligimet e Komunës ndaj kompanisë "Pastrimi", për shkak se kompania "Pastrimi" duhet me ndarë rriskun e Prishtinës, bazuar në kriteret për ndarjen e rriskut, për shkak se Prishtina është e vetmja komunë që arketon mjetet, ndërsa komunat tjera nuk arkëtojnë, kështu që duhet me ekzistuar një planifikim edhe i kompanisë, edhe i bordit, në bashkëpunim me Komunën. Për sot nuk kemi kohë, se është gjendja urgjente, e ne duhet të bëjmë një propozim për t'iu ndihmuar, e për herët tjera kompania "Pastrimi" saktësisht duhet me ditur sa bën shpenzime për mirëmbajtjen e teknologjisë, për paga e shpenzime të tjera, e jo me punuar paushall. Andaj ne sot mundemi ta bëjmë një propozim të lehtë e me iu ndihmuar deri në mbledhjen tjetër.

Vala Peshku tha se të gjitha u thanë nga parafolësit, por dua të shpreh një dashni për këtë Prishtinë, për atë se si është sot duke udhëhequr. Tash e dy ka qenë shembull edhe për komunat tjera,

asnje qeverie as lokale, as qendrore nuk ia kisha dëshiruar me gjetur në kësi gjendje çfarë jemi, andaj dua me lavdëruar secilin prej jush nga ekzekutivi, sinqerisht, për sigurinë që ia keni ofruar çdo qytetari të Prishtinës.

Agim Gashi kërkoi që deri në kohë të seancës, ekzekutivi të mendojë një vlerë për ndërmarrjen "Pastrimi", që të mos kemi telashe.

Kryesuesi tha se çështjen që e ngriti Egzoni për punë të bizneseve të gastronomisë, që tha se mundet me pasur edhe diçka tjeter, një formulim ndoshta kishte me qenë, që të gjitha bizneset që nuk mund të ushtrojnë veprimtari për shkak të masave të Qeverisë me rastin e Covid 19, të cilat paguajnë taksën për shfrytëzimin e hapësirave publike, të lironen nga kjo pagesë për një vit.

Mbledhja përfundoi në orën 13:50.

Procesmbajtësja
Shyhare Islami

Kryesuesi i Komitetit
Agim Kuleta



A handwritten signature in blue ink is placed above a circular official stamp. The stamp contains text in both Cyrillic and Latin scripts, including 'PRISTINA MUNICIPALITY' and 'PRISTINA KOSOVA' around the perimeter, and a central emblem featuring a shield with a castle and a river.